REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 128/17
Datë/Datum. 30.05.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW

PSH. Nr. 128/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, në përbërje prej: z. Ekrem Salihu - Kryetar, z. Goran Milenkovic – Referues, z. Blerim Dina – anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE **"Universal Comerce"** – Fushë Kosovë, përfaqësuar nga z.Esat Zeneli, kundër autoritetit kontraktues-Komuna Fushë Kosovë-përfaqësuar nga z.Bedri Obërtnica, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve zyrtare"**, me nr. të Prokurimit: 612/17/438/221, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Komuna Fushë Kosovë** , më: 25.05.2017, mori këtë :

VENDIM

I. <u>**Aprovohet**</u>, si e bazuar ankesa e OE **"Universal Comerce"** – Fushë Kosovë, lidhur me procedurën e prokurimit me titull: **"Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve zyrtare"**, me nr. të Prokurimit: 612/17/438/221, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Komuna Fushë Kosovë**.

II. <u>**Anulohet,**</u> vendimi i autoritetit kontraktues - **Ministria e Administratës Publike**, lidhur me procedurën e prokurimit me titull: **"Mirëmbajtja teknike e ndërtesave Qeveritare"**, me nr. të Prokurimit: MAP202/16/202/211, si i pa bazuar dhe lënda kthehet ne **Ri-vlerësim.**

III. <u>**Urdhërohet**</u>, autoritetit kontraktues - **Komuna Fushë Kosovë**, që procedurën e prokurimit me titull: **"Mirëmbajtja teknike e ndërtesave Qeveritare"**, me nr. të Prokurimit: MAP202/16/202/211, ta kthej në **Ri-vlerësim**. Mos respektimi i këtij vendimi e detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore nenit 131 të LPP-së nr. 04/L-042, të ndërmarr masa ndaj autoritetit kontraktues.

IV. Meqenëse pretendimet ankimore të operatorit ekonomik ankues "Universal Comerce" - Fushë Kosovë janë të qëndrueshme, konform nenit 118 të LPP-së, i kthehet sigurimi i ankesës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik "Universal Comerce" - Fushë Kosovë, si palë e pakënaqur ka deponuar ankesë në OSHP më 27.05.2017, me nr. të protokollit, 128/17, kundër njoftimit për dhënie të kontratës të OE "Suzuki" – Miradi e Ulët, duke pretenduar se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të LPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 të LPP-së nr. 04/L-042, ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të shqyrtuar procedurën e zhvilluar lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, si dhe vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues në raportin e datës: 19.05.2017, ka konstatuar se AK-ja, i ka respektuar dispozitat e nenit 61 te LPP-së dhe se pretendimi ankimor i parashtruesit të ankesës në lidhje me çmimet Jo-Normalisht te ulëta është i paqëndrueshëm me arsyetimin se sipas nenit 61 te LPP-se, është e drejt dhe përgjegjësi e AK-se qe ti vlerësoj çmimet e ofruara.
Prandaj, eksperti shqyrtues, duke u bazuar në sqarimet e dhëna në raport të ekspertizës i ka propozuar panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe njëherit i ka propozuar panelit shqyrtues që të aprovohet vendimi i AK-së për dhënie të kontratës.

OE ankues "Universal Comerce" - Fushë Kosovë përmes parashtresës ka deklaruar se nuk pajtohet me mendimin dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues të dhënë në raportin e datës 19.05.2017.

AK-ja, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me raportin dhe konstatimet e ekspertit shqyrtues, për këtë aktivitet të prokurimit.

Gjatë seancës së shqyrtimit kryesor, më 25.05.2017, ne te cilën ishin prezent anëtarët e Panelit shqyrtues, eksperti shqyrtues, përfaqësuesi i autorizuar i OE. ankues, përfaqësuesi i AK-së . Në seancë u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, përgjigjja e AK-së mbi raportin e ekspertizës si dhe parashtresa e OE ankues lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Gjatë seancës dëgjimore z.Zeneli ndër të tjera deklaroi :" Ne kundërshtojmë raportin e ekspertit shqyrtues sa i përket konstatimit lidhur me çmimin sepse ekspertja nuk ka respektuar fare tabelën e KRPP-së lidhur me kushtin apo pragun mesatar të nxjerrjes së çmimeve.
Në rastin konkret i paraqesim panelit shqyrtues tabelën sipas formulës së KRPP-së, Lidhur me çmimet e ofertuesve për këtë aktivitet të prokurimit, ku dëshmohet se OE. i rekomanduar për kontratë ka ofruar çmime jo normalisht të ulëta. Dhe i njëjti nuk e kalon pragun mesatar konform tabelës së KRPP-se, lidhur me kalkulimin e çmimeve jo normalisht të ulëta.

Në bazë të kësaj formule te KRPP-së rezulton se ofertat e OE-ve janë nën pragun e lejuar me çmim jo normalisht të ulët, pasi që pragu mesatar është 68,933.39€.
Të gjitha ofertat që janë nën këtë çmim të pragut mesatar janë me çmim jo normalisht të ulët.
Këtu kemi të bëjmë me çmim total dhe jo sipas çmimeve për njësi, sepse KRPP ka paraparë se oferta financiare vlerësohet si total dhe jo për çmime për njësi pasi edhe kriter i dhënies së

kontratës është çmimi më i ulët dhe nuk mund të bëhet poentimi i çmimit, sepse vetëm në rast kur kemi kriter tenderi më i favorshëm ekonomikisht mund të bëhet poentimi i çmimit apo vlerësimi i çmimit për njësi.
Ofertat e paraqitura më poshtë nuk mund të kalojnë pragun e çmimit:
OE:"Dragusha" me cmim 51,027.82€.
OE:"Fordi" me cmim 51,923.63€.
OE:"Suzuki" me cmim 49,818.50€.

AK-ja, në këtë aktivitet ka shpallur të gjithë OE-të të përgjegjshëm (5 OE pjesëmarrës).
Kërkojmë nga paneli shqyrtues që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe ky aktivitet të kthehet në Rivlerësim".

Në vazhdim fjala iu dha përfaqësuesit të AK-KK Fushë Kosovë z.Obërtinca i cili deklaroj: Ne si AK-KK Fushë Kosovë pas ekzaminimit, krahasimit dhe vlerësimit të ofertave kemi rekomanduar për kontratë OE :"DPZ SUZUKI" pasi që ka ofruar çmimin më të ulët dhe është i përgjegjshëm me dokumentacionin e kërkuar në dosje të tenderit.
Pala ankimore është renditur e katërta me radhë për nga çmimi dhe është e fundit nga ofertuesit e përgjegjshëm, andaj edhe nuk është rekomandua për kontratë.

Kemi edhe OE. të pestë që ka ofruar çmim mbi 250.000€, andaj është vlerësuar i papërgjegjshëm si për nga dokumentacioni i kërkuar në dosje ashtu edhe nga çmimi që ka ofruar.
Do thotë ka ofruar 100% çmim më të lartë se buxheti i i paraparë i AK-së.
Nga mbi 5000 artikuj të prezantuar në paramasë, mund të ketë edhe çmime më të ulët se çmimi i tregut nga të gjithë OE-të pjesëmarrës pa përjashtim, dhe jo vetëm nga OE i rekomanduar për kontratë.
Ne si AK, kemi për qëllim ruajtjen e buxhetit andaj oferta e OE :"Univerzal Comjerc" me vlerë prej 92.000€ afërsisht është shumë më e lartë se oferta e DPZ Suzuki në vlerë afër 50.000€.
Pra në këtë rast buxheti komunë sdo dëmtohej dukshëm".

Në vazhdim fjala iu dha ekspertit shqyrtues znj.Bullatovci e cila deklaroj:
Pretendimi i OE. ankues ka të bëjë me shkelje nenit 61 të LPP-se, për çmim e jo normalisht të ulëta për OE të rekomanduar për kontratë.

AK me 06.04.2017 përmes letrës standarde kërkesë për informata për tender jo normalisht të ulët ka kërkuar nga OE. i rekomanduar për kontratë sqarime rreth disa pozicioneve ku ka ofrua çmim jo normalisht të ulët. OE. i ka kthyer përgjigje AK duke deklaruar se qëndron pranë çmimeve të dhëna dhe do përmbushë kontratën sipas atyre çmimeve.

Mendoj se autoriteti kontraktues bazuar në nenin 61 të LPP ka drejtë dhe përgjegjësi një tender ta konsideroj jo normalisht të ulët apo jo, e në rastin konkret AK pas marrjes së konfirmimit nga OE. ka konsideruar se tenderi nuk është me çmim jo normalisht të ulët.

Lidhur me pretendimin në fjalë OE. ka kërkuar interpretim prej KRP me 12.04.2017 të cilin ja ka bashkangjitur edhe ankesës.
Interpretimi i KRPP thuhet "nëse krahasohet vlera parashikuar e projektit që ju keni shkruar 124.000€, ndërsa oferta që OE i atakon në total për çmime jo normalisht të ulëta, konsiderojmë se sipas rregullave neni 3.1 i rregullave duhet trajtuar si çmime jo normalisht të ulëta".
Mirëpo në vazhdim të interpretimit të KRPP thuhet decidivisht "KRPP konsideron se AK duhet që gjithsesi ti verifikoj se a janë çmime të tregut apo jo sipas UOPP-së, neni 4, janë në përgjegjësi të AK që ato oferta ti trajtoj për çmime jo normalisht të ulëta që përcaktohen me rregullat për çmim jo normalisht të ulët neni 4.2".

Për mendimin tim si eksperte shqyrtues edhe interpretimi i KRPP përgjegjësia i takon AK-së që njëjtën ta konsideroj si tender jo normalisht të ulët apo jo.

Përfaqësuesi i OE z.Zeneli në fjalë përfundimtare deklaroj:" i propozojmë panelit shqyrtues që të merr për bazë ankesën tonë dhe të bëjë zbërthimin e formulës dhe të merr vendim meritor".

Në fjalë përfundimtare përfaqësuesi i AK z.Obërtinca deklaroj: OE. i pestë me çmim 250.000€ është OE i papërgjegjshëm edhe me dokumentacion, e po ashtu edhe me çmim i cili është 100% më i lart se vlera parashikuar e AK-së".

Paneli shqyrtues, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, raportit të vlerësimit të komisionit vlerësues të AK-së, shqyrtimit të pikave pretenduese të parashtruesit të ankesës, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues të cekur në ekspertizë, parashtresës së OE. ankues, parashtresës së AK-së, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, konstaton dhe vlerëson se AK-ja nuk e ka respektuar nenin 59 të LPP-së, pasi që nuk është bërë ekzaminimi i ofertës financiare, konkretisht çmimet e ofruara nga OE-te, ne lidhje me disa produkte te cilat i ka kërkuar autoriteti kontraktues – Komuna e Fushë Kosovës.

Paneli shqyrtues gjatë seancës dëgjimore bëri vështrim të raportit të vlerësimit të komisionit vlerësues dhe në bazë të të cilit u konstatua se komisioni i vlerësimit dhe autoriteti kontraktues i ka shpallur të 5(pestë) ofertat të përgjegjëshme dhe se pretendimi i përfaqësuesit të autoritetit kontraktues se në këtë aktivitet të prokurimit janë vetëm 4 oferta të përgjegjëshme nuk qëndron.

Ne lidhje me çmimet e produkteve, paneli shqyrtues konstaton dhe vlerëson se autoriteti kontraktues – Komuna e Fushë Kosovës, është dashur qe gjate fazës se vlerësimit te ofertave te aplikoj Rregulloren për çmime Jo-Normalisht te ulëta – versionin e korigjuar te datës: 07.07.2016 sepse ky aktivitet i prokurimit është iniciuar me date: 27.02.2017 dhe krejt kjo duke u bazuar se ka dallim te madh ne mes te ofertave konkurruese ne këtë aktivitet te prokurimit.

Andaj, paneli shqyrtues, pasi i ka analizuar te gjitha provat, gjithashtu ne lidhje me pretendimin e OE. ankues, se tre operatoret ekonomik: "Dragusha", "Fordi" dhe "Suzuki" nuk e kalojnë pragun sipas Rregullores për çmime Jo-Normalisht te ulëta, konstaton se ne bazë te Rregullores për çmime Jo-Normalisht te ulëta pragu për tu konsideruar oferta financiare me çmim Jo-Normalisht te ulet janë te gjitha ofertat me çmim nen 83,580.75 euro. Pra të gjitha ofertat që kanë çmimin nën 83,580.75 euro janë oferta me çmim jo-normalisht të ulët.

Me rastin e marrjes së këtij vendimi paneli shqyrtues pati parasysh edhe interpretimin e Krpp-së të dt.13.04.2017 përmes së cilit interpretim edhe Krpp-ja ka deklaruar se sipas nenit 3.1 të rregullores për çmime jo-normalisht të ulëta të gjitha ofertat nën pragun e lartpërmendur duhet të trajtohen si oferta me çmime jo-normalisht të ulëta.

Obligohet autoriteti kontraktues që me rastin e ri-vlerësimit të ofertave të bëjë aplikimin e Rregullores për çmime jo-normalisht të ulëta të nxjerrur dhe aprovuar nga ana e Krpp-së e më pastaj të marrë vendim meritor.

Prandaj Paneli shqyrtues, duke u bazuar në nenin 117 të LPP-së, si dhe duke u mbështetur në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1. 1x1 AK – Komunës se F.Kosovës
2. 1x1 OE - "Universal Comerc"
3. 1x1 - Arkivës së OSHP-së

Këshillë Juridike :
Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur
nuk mund të ushtron ankesë,
por për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh,
pas pranimit të këtij vendimi, mund të ngritë
kërkesë-padi në Gjykatën Themelore - Prishtinë
Departamenti për Çështje Administrative.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
Ekrem Salihu